



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1259/3 /prot

Tiranë, më 21.09 2020

URDHËR

Nr. 178/3, datë 21.09 2020

MBI

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 182, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE E
DOKUMENTACIONIT PËR VKLRESËSIMIN DHE PËRFITIMIT E PAGESËS PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, SI DHE NDIHMËSIT PERSONAL", TË
NDRYSHUAR**

Bazuar në ligjin nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", pikat 1 dhe 6 të kreut III të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimit e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personal", të ndryshuar si dhe vendimit nr. 135, datë 7.03.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Statusit të Shërbimit Social Shtetëror",

URDHËROJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut III, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020 të Këshillit të Ministrave, bëhet 10.845 (dhjetëmijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë në muaj.
2. Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar, i përcaktuar në shkronjën "b", të nenit 8 , të ligjit nr.57/2019.
3. Pagesa e ndihmësit personal të personit me aftësi të kufizuar të përcaktuar në shkronjën "a" të nenit 8 të ligjit 57/2019 bëhet 11.391 (njëmbëdhjetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë në muaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektin financiarë nga 01.09.2020.



DREJTORI PËRGJITHSHËM

Luneda Sufali